



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca: 626-20-023-1-3-6

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë;

Dhe

Operatori Ekonomik " **MEDIATECH & PRINT** " SH.P.K. me numer të biznesit: **810839425**, selia në **Prishtinë** i përfaqësuar me autorizim nga z. **Veli Musa**, në cilësinë e **punëtorit** të Operatorit Ekonomik (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizime si më poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

"FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR ZYRE TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRË NË KONTRATËN E AQP-s"

Numri i Prokurimit: 626-20-4658-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate ka të bëjmë furnizimin e materialeve shpenzuese të cilat nuk janë të parapara në kontratat e AQP-s si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME			
" FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR ZYRE TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRË NË KONTRATËN E AQP-s"			
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1.	Markera wite bord Hi-tech me ngjyra Zi-Blu dhe Kuq	Copë	2,800.00
2.	Shpuzë për tabelë T-29	Copë	25.00
3.	Topat e futbollit të jen kualitativ të qepur me dy shtresa, shtresa e jashtme 1.5 mm nga materiali lëkurës kurse shtresa e brendshme nga materiali late. Madhësia e topit të futbollit nr 5 nga malten, adidas, nike ose ekuivalent.	Copë	20.00
4.	Topat e volejbollit të jen kualitativ me 18 panele nga lëkura sintetike kurse shtresa e brendshme te jete nga goma "butyl" madhësia nr 5 nga adidas, molten nike	Copë	13.00



	ose ekuivalent.		
5.	Topat e basketbollit të jen kualitativ me dy shtresa nga marka spallding,adidas,molten ose ekuivalent.	Copë	5.00
6.	Rrjeta volejbolli me gjatësi 9.7 m gjerësia 1m trashësia e fijos së rrjetës 3 mm, duhet të ketë kabllon e çelikut me gjatësi minimumi 11 m	Copë	1.00
7.	Topa hendbolli nga lëkura sintetike e punuara me teknologji te qepjes madhësia nr. 1 dhe 2	Copë	3.00
8.	Hamera DC204,DC205,DC207	Copë	25.00
9.	Shtypja dhe furnizimi me urdhër për shfrytëzimin e automobilit të udhëtarëve për udhëtim zyrtar. Të jetë në formatin A5, me logon e KK Mamushë dhe Rep. e Kosovës, të jetë e përpiluar në tre gjuhë Turqisht,Shqip dhe Serbisht, me një flet me tre kopje indigo, dhe një numër serik.	Copë	500.00

1.2 Kontrata do të hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të sajë nga ana e të dy palëve, ndërsa do të përfundoj pas furnizimit të të gjitha artikujve.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 15 (Pesëmbëdhjetë) ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi kryesor i dorëzimit ose i realizimit është Ndërtesa e QMF-së në Mamushë.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,177.25 €; Njëmijë e shtatqindë e shtatëdhjetë e shtatë Euro e njëzet e pesë Eurocent.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimi të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Operatori ekonomik duhet të ofroj materialet e kualitetit të lartë të përshkruar sipas specifikacionit teknik të cekur në dosjen e tenderit. Në rast të konstatimit të ndonjë të metë të mallit nga njësia e pranimi Operatori Ekonomik është i detyruar që mallin ta zëvendësoj me mall pa të metë.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Ekonomike në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Veli Musa	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Punëtor	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.10.2020	Data:	05.10.2020
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUŠHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA




Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: "Furnizimi me material shpenzues për zyre të cilat nuk janë të përfshira në kontratën e AQP-s"

Nr i prokurimit	626-20-4658-1-3-6
Nr i brendshëm	626-20-023-1-3-6

PJESA E DYTË: Furnizimi me material shpenzues për zyre të cilat nuk janë të përfshira në kontratën e AQP-s					
Nr.	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1.	Markera wite board Hi-tech me ngjyra Zi-Blu dhe Kuq	Copë	2,800.00	0.18	504
2.	Shpuzë për tabelë T-29	Copë	25.00	0.25	6.25
3.	Topat e futbollit të jen kualitativ të depur me dy shtresa, shtresa e jashtme 1.5 mm nga materiali lëkurës kurse shtresa e brendshme nga materiali late. Madhësia e topit të futbollit nr 5 nga malten, adidas, nike ose ekuivalent.	Copë	20.00	10	200
4.	Topat e volejbollit të jen kualitativ me 18 panele nga lëkura sintetike kurse shtresa e brendshme te jete nga goma "butyl" madhësia nr 5 nga adidas,molten nike ose ekuivalent.	Copë	13.00	7	91
5.	Topat e basketbollit të jen kualitativ me dy shtresa nga marka spalding,adidas,molten ose ekuivalent.	Copë	5.00	10	50



6.	Rrjeta volejboli me gjatësi 9.7 m gjatësia 1m trashësia e fije së rrjetës 3 mm, duhet të ketë kabllon e çelikut me gjatësi minimumi 11 m	Copë	1.00	15	15
7.	Topa hendbolli nga lëkura sintetike e punuara me teknologji te qepjes madhësia nr. 1 dhe 2	Copë	3.00	2	6
8.	Hamera DC204,DC205,DC207	Copë	25.00	0.4	10
9.	Shtypja dhe furnizimi me urdhër për shfrytëzimin e automobilit të udhëtarëve për punë zyrtare. Të jetë në formatin A5, me logon e KK Mamushë dhe Rep.e Kosovës, të jetë e përpiluar në tre gjuhë Turqisht,Shqip dhe Serbisht,me një flet me tre kopje indigo, dhe një numër serik.	Copë	500.00	0.59	295
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet					1177.25€

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	MEDIATECH&PRINT SHPK
ADRESA E PLOTE	TREGU ME SHUMICE TE AMORTIZERAT
Përfunduar Nga:	
EMRI & MBIEMRI	NEXHIMEDIN VEZIRI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	01-09-2020
VULA	

